



REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSQVO
KOMUNA E VUSHTRRIË-OPŠTINA VUÇITRN

01 Nr. / Br 128/14

Nr. i fq. / Br. st -19-

Data: / Datum 28.05.2014

VUSHTRRI - VUÇITRN



Republika e Kosovës

Kuvendi i Komunës- Vushtri

STATUTI

I QENDRËS KRYESORE I MJEKËSISË FAMILJARE

Maj, 2014

Në bazë të nenit 12.2 pika "d", nenit 17.1 pika "j" të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), nenit 18.3 në lidhje me nenin 45.1 dhe 2 të Ligjit Nr. 04/L-125 për Shëndetësi në Kosovë, nenit 41.2 pika "c" të Statutit të Komunës së Vushtrrisë, Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë, në mbledhjen e mbajtur më 28.05.2014, miratoi këtë:

S T A T U T

TË QENDRËS KRYESORE TË MJEKËSISË FAMILJARE

I - Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë statut rregullohen: dispozitat e përgjithshme, emërtimi dhe selia, veprimtaria e QKMF-së, statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi, struktura e institucionit, udhëheqja dhe trupat e institucionit, zhvillimi i vazhdueshëm institucional, mbikëqyrja e QKMF-së, aktet e përgjithshme të QKMF-së, pronësia dhe financimi, transparenca në punë, konfidenca profesionale dhe afariste, organizimi sindikal, mbikëqyrja e brendshme, dispozitat kalimtare dhe përfundimtare lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së kujdesit shëndetësor në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (në tekstin e mëtejme: QKMF).

Neni 2

- 2.1. QKMF-ja ofron dhe zbaton Kujdesin parësor shëndetësor publik në territorin e Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme: KPSHP).
- 2.2. Themelues i QKMF- së është Kuvendi Komunal.

Neni 3

- 3.1. QKMF-ja ka në shfrytëzim mjetet dhe pasurinë, e cila është pronë e Kuvendit Komunal.
- 3.2. QKMF-ja, si institucion i KPSHP-së, është përvetësuese e Fondit për financim nga Buxheti i Kosovës.

II - Emërtimi dhe Selia

Neni 4

- 4.1. Emri i institucionit është: Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare;
- 4.2. Shenja njohëse e këtij institucioni është unike për të gjitha QKMF-të në Republikën e Kosovës dhe aprovet nga Kuvendi komunal, në bazë të procedurave ligjore;
- 4.3. Emërtimi i QKMF-së, QMF-së dhe AMF-së duhet të jetë i mbishkruar qartë në hyrje të objektit, në të cilin kryhet veprimtaria shëndetësore dhe edukative, në gjuhët, të cilat janë në përdorim zyrtar në Kosovë;

4.4. Për ndryshimin e selisë së QKMF-së vendos themeluesi, pas marrjes së pëlqimit nga ministria kompetente.

Neni 5

Selia e QKMF-së është në Vushtrri, rr. e "Çamërisë", pa numër.

Neni 6

- 6.1. QKMF-ja posedon vulën e saj që në qarkullimin juridik paraqitet si Qendër Kryesore e Mjekësisë Familjare;
- 6.2. Vula është në formë të rrumbullakët dhe ka dimension 3.5 cm ose 35 mm:
 - 6.2.1. rrethi i parë: Republika e Kosovës,
 - 6.2.2. rrethi i dytë: Komuna e Vushtrrisë,
 - 6.2.3. rrethi i tretë: QKMF,
 - 6.2.4. në mes të vulës është logoja;
- 6.3. QKMF-ja posedon vulën katrore, me dimensione 5.5 cm x 3 cm, që përmban emërtimin, selinë, hapësirën për evidentimin e numrit dhe të datës së pranimit të dokumentit;
- 6.4. Vula duhet të përmbajë emërtimin e institucionit sipas nenit 4.1 të këtij statuti dhe duhet të jetë në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës;
- 6.5. Për numrin e vulave, mënyrën e përdorimit, autorizimin e personit për përdorim dhe ruajtje, vendos drejtori;
- 6.6. Çdo vulë ka numër identifikues.

III - Veprimtaria e QKMF-së

Neni 7

- 7.1. Veprimtaria e QKMF-së përfshin ofrimin e shërbimeve parësore shëndetësore për popullatën e komunës, si një veprimtari me interes të veçantë, përmes zbatimit të konceptit të mjekësisë familjare, në kuadër të sistemit unik shëndetësor të Kosovës;
- 7.2. Koncepti i mjekësisë familjare konsiston që të gjithë banorëve të Komunës së Vushtrrisë, t'u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuara në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuesit e shërbimeve në sistemin shëndetësor dhe njëherësh pikë referuese për specialistët konsultant, në nivele të tjera të kujdesit shëndetësor;
- 7.3. Sipas strategjisë së KPSHP-së dhe standardeve të vendosura në UA të MSh-së, që nxirren në pajtim me Ligjin e Shëndetësisë 2014, të mjekësisë familjare, ekipi i mjekësisë familjare ofron shërbime shëndetësore për 2000/2500 banorë sipas shtrirjes territoriale, gjeografike dhe organizimit të QKMF-së;
- 7.4. Standardet e mjekësisë familjare sipas nenit 7.3 të këtij statuti, do t'i nënshtrohen revidimit periodik nga ana e MSH-së.
- 7.5. Shërbimet shëndetësore në QKMF sigurohen dhe zbatohen nga profesionistët shëndetësorë, të cilët i plotësojnë kriteret e parapara në Ligjin

për Shëndetësi dhe aktet e tjera nënligjore të MSH-së që rregullojnë këtë fushë, me këtë përbërje:

- a. Specialist nga mjekësia familjare,
- b. Doktor i mjekësisë,
- c. Doktor i stomatologjisë,
- d. Pedodont,
- e. Farmacist i diplomuar – magjistër i farmacisë,
- f. Specialist i biokimisë klinike,
- g. Infermiere e diplomuar,
- h. Infermier/e,
- i. Asistent stomatologu,
- j. Profesionistët shëndetësor të tjerë me kualifikim të mesëm dhe të lartë, të përcaktuar në regjistrin zyrtar të ministrisë,
- k. Bashkëpunëtorët profesional me shkollim jashtë lëmit të mjekësisë, të evidentuar në regjistrin zyrtar me vendim të ministrit të shëndetësisë, në bazë të propozimit të odës përkatëse të profesionistëve, nga neni 78 i këtij ligji.

7.6. Në kujdesin parësor shëndetësor nuk duhet të bëhet pranimi i specialistëve nga lëmitë e tjera, specialistët nga lëmitë e tjera, që tani gjenden në KPSHP, mund të vazhdojnë punën në këto institucione si konsultat të mjekëve familjar deri në pensionim;

7.7. Standardet e organizimit dhe të funksionimit të shërbimit të mjekësisë familjare në komuna, janë përcaktuar me aktet nënligjore të MSH-së.

Neni 8

QKMF kryen këto shërbime të kujdesit parësor shëndetësor:

- a) Parandalimin, mjekimin dhe shërimin që ka të bëjë me sëmundjet, çrregullimet dhe lëndimet,
- b) Edukimin, promovimin dhe përparimin shëndetësor,
- c) Kujdesin shëndetësor riprodhues, që përfshin kujdesin shëndetësor para dhe gjatë shtatzënisë, lindjes dhe lehonave, si dhe metodat e planifikimit të familjes,
- d) Kujdesin për nëna, fëmijë dhe adoleshentë,
- e) Imunizimin dhe vaksinimin,
- f) Promovimin dhe monitorimin e rritjes dhe zhvillimit të fëmijëve deri në moshën 5 vjeç, si dhe parandalimin e kariesit të dhëmbëve,
- g) Promovimin e shëndetit oral dhe kujdesin themelor stomatologjik,
- h) Kujdesin për shëndetin mendor, bazuar në bashkësi,
- i) Zbulimin e hershëm të sëmundjeve ngjitëse, masat kundërepidemike dhe ruajtjen e shëndetit publik,
- j) Përcaktimin e diagnozës fillestare, përfshirë edhe ndërhyrjet e vogla kirurgjike,

- k) Ofrimin e kujdesit urgjent, stabilizimin dhe transportin deri në institucionet referente,
- l) Kujdesin për të sëmurët kronik,
- m) Kujdesin për të moshuar dhe atë paliativ,
- n) Kujdesin shtëpiak përmes vizitave në komunitet.

IV - Statusi juridik, përfaqësimi dhe prezantimi

Neni 9

9.1. QKMF-ja në Vushtrri është institucion, i cili bën pjesë në rrjetin e institucioneve shëndetësore publike të Ministrisë së Shëndetësisë;

9.2. QKMF-ja kryen dhe ofron shërbime të kujdesit parësor për qytetarët e komunës, sipas dispozitave ligjore që janë në fuqi;

9.3. Për nënshkrimin e kontratave, më të cilat fitohen, tjetërsohen apo shiten objektet dhe pajisjet kapitale, me ose pa vlerë rigjeneruese të QKMF-së, duhet të ketë së pari propozimin e menaxhmentit të QKMF-së dhe aprovimin e themeluesit, në bazë të ligjeve në fuqi.

Neni 10

Drejtori i QKMF-së ka të gjitha autorizimet për përfaqësimin juridik dhe afarist, brenda veprimtarisë së QKMF-së, duke marrë për bazë përkufizimet e këtij statuti.

V - Struktura e Institucionit

Neni 11

11.1. Udhëheqja dhe mbikëqyrja e QKMF-së bëhet nga drejtori;

11.2. QKMF-ja me qëllim të ofrimit të përkujdesjes shëndetësore për banorët e vet, është e organizuar në këto njësi përbërëse:

11.2.1. Departamenti i Mjekësisë Familjare përbëhet nga:

a. Sektori i mjekësisë familjare,

b. Sektori i shëndetit publik:

-Njësia e SISH,

-Njësia e vaksinimit dhe imunizimit,

c. Sektori i shëndetit oral preventiv,

ç. Sektori i kujdesit urgjent,

d. Sektori i diagnostikës:

-Kabineti radiologjik,

-Laboratori.

11.2.2. Departamenti i Administratës, varësisht nga madhësia e QKMF-së, mund të organizohet në njësi:

Zyra e personelit,

Zyra juridike,

Zyra për buxhet dhe financa,

Zyra për shërbime teknike;

11.2.3. Barnatorja qendrore:

a. Barnatorja është njësi organizative e QKMF-së, e cila themelohet dhe funksionon sipas ligjeve dhe akteve nënligjore që rregullojnë aktivitetin farmaceutik,

b. Në barnatore të QKMF-së mund të shpërndahen vetëm barnat nga Lista Esenciale e Barnave, e lejuar nga ministria dhe të përshkruara në recetat unike, nga mjekët e Sektorit të mjekësisë familjare,

c. Çdo tregtim me barna komerciale në barnatoret brenda QKMF-së, është i ndaluar dhe sanksionohet sipas ligjeve në fuqi,

ç. Barnatoren e udhëheq shefi i barnatores;

11.3. Për të përmbushur obligimet që dalin nga Ligji për Shëndetësi, në QKMF funksionon edhe Qendra e Trajnimit e Mjekësisë Familjare (QTMF), si Njësi e Qendrës së Zhvillimit të Mjekësisë Familjare (QZHMF) ku mbahet trajnimi i mjekëve dhe infermierëve, në programet e Mjekësisë/Infermierisë Familjare;

11.4. Lista e Qendrave të mjekësisë familjare dhe ambulancave familjare në kuadër të QKMF-së në Vushtrri, përbën rrjetin e institucioneve të KPSH-së në Komunën e Vushtrrisë. Ky rrjet i institucioneve shëndetësore do të jetë objekt i revidimit periodik që do të ndërmerret nga KK i Vushtrrisë dhe MSH-së.

Sistemi i Informimit Shëndetësor në QKMF

Neni 12

12.1. QKMF-ja në Vushtrri zbaton sistemin unik të informimit shëndetësor, ashtu siç është paraparë me Ligjin e Shëndetësisë dhe aktet nënligjore që rregullojnë këtë lëmi;

12.2. Për qëllime të Sistemit të Informimit Shëndetësor, Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Shëndetësisë (DKSH-në) dhe QKMF-në, do të zhvillojnë një sistem unik të kodeve për të gjitha QKMF-të dhe departamentet e saj;

12.3. QKMF-ja bën mbledhjen, evidentimin, vendosjen e të dhënave statistikore në Shërbimin e Informimit Shëndetësor (SHISH), në programin kompjuterik të Ministrisë së Shëndetësisë, i cili përmban të dhënat e nevojshme për shfrytëzimin e shërbimeve shëndetësore;

12.4. Çdo profesionist shëndetësor, gjatë raportimit duhet të sigurojë fshehtësinë profesionale duke mos cenuar të drejtat e pacientit, përveç rasteve të rregulluara me ligj.

**Udhëheqja dhe trupat e QKMF-së,
Këshilli Drejtues**

Neni 13

Këshilli Drejtues udhëheq tërë aktivitetin e QKMF –së, nën udhëheqjen e drejtorit.

Neni 14

14.1. Këshilli drejtues ka 5 anëtarë, ata janë:

- a. Drejtori i QKMF-së, i cili edhe e kryeson këshillin,
- b. Kryeshefi i Departamentit të Mjekësisë Familjare,
- c. Kryeinfermieri i QKMF-së,
- d. Kryeshefi i administratës,
- e. Koordinator i për ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore;

14.2. Mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues zgjat sa edhe kontrata e punës së tyre, por mund të përfundojë edhe më parë në rastet kur:

- a) Anëtari ndërpret marrëdhënien e punës në QKMF,
- b) Anëtari i Këshillit drejtues jep dorëheqje,
- c) Anëtari i Këshillit drejtues mungon pa arsye në mbledhje të këshillit, brenda vitit, tri herë radhazi,
- d) Anëtari nuk respekton detyrat e punës.

Neni 15

Anëtarëve të Këshillit drejtues mund t’ju përfundojë mandati edhe në këto raste:

- a. Nëse nuk u përmbahen politikave parimore të themeluesit,
- b. Nëse marrin pjesë në nxjerrjen e vendimeve joligjore ose vendimeve, të cilat i shkaktojnë dëm QKMF-së.

Neni 16

16.1. Këshilli drejtues kryen këto punë të parapara me këtë statut dhe vendos për:

- 16.1.1. Veprimtarinë e QKMF-së dhe vërteton politikën punuese të QKMF-së,
- 16.1.2. Propozimet e ndryshimeve të Statutit të QKMF, të cilat i aprovon (MSH),
- 16.1.3. Aprovimin e raportit të punës dhe llogaritë vjetore të QKMF-së dhe raportin në Divizionin e Kujdesit Parësor në MSH, përmes Drejtorisë Komunale për Shëndetësi,
- 16.1.4. Shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të ligjit,
- 16.1.5. Përgatitjen e programit të punës dhe planin financiar,
- 16.1.6. Përgatitjen e Rregullores për organizimin e punës në QKMF dhe aktet tjera në përputhshmëri me ligjin dhe me këtë statut,
- 16.1.7. Përgatitjen e planit të burimeve njerëzore sipas propozimit të Këshillit profesional, brenda resurseve të disponueshme dhe në përputhje me politikën e MSH-së,

- 16.1.8. Aprovimin e çmimeve të shërbimeve shëndetësore, të cilat i ofron QKMF, dhe të cilat nuk janë të përcaktuara nga ana e MSH-së,
- 16.1.9. Planin e furnizimit të QKMF-së dhe vendos për dhënien në shfrytëzim të lokaleve dhe mjeteve, furnizimin dhe dhënien në shfrytëzim të mjeteve të veçanta pas marrjes së pëlqimit nga DKSH-ja dhe MSH-ja,
- 16.1.10. Planin mbi ZHVP të kuadrit mjekësor, bashkëpunëtorëve shëndetësor dhe siguron aplikimin e tij,
- 16.1.11. Planin dhe programin e masave për mbrojtje në pune,
- 16.1.12. Mbarëvajtjen e punëve,
- 16.1.13. Emërimin e komisioneve të përkohshme dhe organeve tjera punuese,
- 16.1.14. Sigurimin e pasurisë së QKMF-së, sigurimin e punëtorëve në bazë të ligjit,
- 16.1.15. Propozimin e ndërtimit dhe adaptimit të objekteve, si dhe për burimet e mjeteve për kryerjen e këtyre punimeve, duke u bazuar në politikën shëndetësore,
- 16.1.16. Shqyrtimin e njoftimeve mbi mbikëqyrjen e raporteve të përkohshme, mbi punën profesionale,
- 16.1.17. Kryen edhe punë të tjera, të cilat i janë lënë në kompetencë, me këtë statut dhe aktet tjera normative të QKMF-së.

Neni 17

- 17.1. Këshilli drejtues i QKMF- së i kryen detyrat brenda përgjegjësisë të veta në mbledhje;
- 17.2. Këshilli drejtues mban mbledhje, në të cilat marrin pjesë më tepër se gjysma e anëtarëve;
- 17.3. Këshilli drejtues merr vendime në shumicën e votave të anëtarëve të zgjedhur;
- 17.4. Në mbledhjen e Këshillit drejtues mbahet procesverbali, të cilin e aprovojnë pjesëmarrësit në mbledhjen vijuese;
- 17.5. Këshilli Drejtues propozon Rregulloren e Punës së QKMF-së, në të cilën më detajisht rregullohen çështjet që kanë të bëjnë me lëmin e punës dhe të cilat nuk janë të rregulluara me ligj dhe më këtë statut.

Drejtori i QKMF-së

Neni 18

- 18.1. Drejtori përfaqëson dhe prezanton QKMF-në dhe është përgjegjës për menaxhimin dhe ligjshmërinë e punës;
- 18.2. Drejtori i QKMF- së përgjigjet për menaxhimin mjekësor, administrativ dhe financiar të të gjitha funksioneve të shërbimeve në QKMF-së, drejtorit komunal për shëndetësi;
- 18.3. Drejtori komunal për shëndetësi, vlerëson çdo vit performancën e drejtorit të QKMF-së.

Procedura për emërimin dhe shkarkimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit

Neni 19

19.1. Drejtorin e QKMF-së e zgjedh dhe e shkarkon Kryetari i komunës, përmes Drejtorisë Komunale për Shëndetësi, në pajtim me ligjet në fuqi;

19.2. Drejtor i QKMF-së duhet të zgjidhet personi, i cili i plotëson kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të punësimit, në bazë të ligjeve në fuqi:

a) Të jetë mjek specialist nga Mjekësia familjare,

b) Përparësi do të kenë dhe kandidatët me shkollim superior mjekësor, të cilët kanë përvojë të dëshmuar në procesin e implementimit të mjekësisë familjare ose kandidatët me shkollim profesional në fushën e menaxhimit shëndetësor,

c) Kandidati për drejtor, preferohet t'i ketë 5 vite përvojë pune në menaxhim të institucioneve publike të KPSH-së;

19.3. Zëvendësdrejtor i QKMF-së emërohet nga Këshilli drejtues në propozim të drejtorit të QKMF-së;

19.4. Me kërkesë të drejtorit, kryeshefi i Departamentit të Mjekësisë Familjare, i cili në të njëjtën kohë ushtron edhe pozitën e zëvendësdrejtorit të QKMF-së, ndihmon në ushtrimin e detyrave të përditshme, udhëheq dhe koordinon aktivitetet e brendshme të QKMF-së dhe vepron në emër të drejtorit, në mungesë të tij.

Neni 20

20.1. Vendimin për publikimin e konkursit për drejtor të QKMF-së e merr drejtori i DKSH-së me autorizim paraprak të Kryetarit të komunës;

20.2. Kryetari i komunës autorizon Drejtorinë Komunale për Shëndetësi të shpallë konkursin për drejtor të QKMF-së.

Neni 21

21.1. Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për të siguruar ligjshmëri në punë dhe afarizmin e QKMF-së, si dhe për punën profesionale të QKMF-së, e cila duhet të organizohet dhe udhëhiqet në pajtim me dispozitat e këtij statuti dhe akteve tjera ligjore;

21.2. Drejtori i QKMF-së është përgjegjës për përkujdesjen eficiente dhe efektive të shëndetësisë parësore publike, për të gjithë banorët e Komunës së Vushtrrisë dhe përgjigjet për detyrat që vijojnë:

a. Në pajtim me Politikën Shëndetësore, Ligjin për Shëndetësi të Kosovës dhe Strategjinë e Kujdesit Parësor Shëndetësor, drejtori i QKMF-së i propozon për miratim Drejtorisë Komunale për Shëndetësi, Planin e Punës dhe Buxhetin e QKMF-së për vitin vijues,

b. Drejtori është përgjegjës për implementimin e Planit të burimeve njerëzore, sipas nenit 15 pika 7,

c. Nën mbikëqyrjen dhe autorizimin e drejtorit të DKSH-së, zbaton buxhetin e QKMF-së,

- ç. Është përgjegjës për udhëheqjen e përditshme të procesit të punës në QKMF,
 - d. Avancoon punën ekipore,
 - dh. Mundëson zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe trajnimin e personelit të QKMF-së,
 - e. Menaxhon implementimin e standardeve të cilësisë,
 - ë. Kontribuon në zhvillimin e sistemit të informimit shëndetësor të QKMF-së,
 - f. Identifikon partnerët dhe zhvillon marrëdhënie me donatorët, OQ dhe me OJQ;
- 21.3. Programi i punës së QKMF-së, realizohet duke u bazuar në politikat zhvillimore të sistemit shëndetësor, të lëshuara nga MSH-ja.
- 21.4. Në programin vjetor të punës, duhet të përcaktohen objektivat, aktivitetet dhe rezultatet e pritura në QKMF, si:
- a. Plani vjetor i punës,
 - b. Organizimi dhe udhëheqja,
 - c. Burimet njerëzore,
 - ç. Plani financiar,
 - d. Raportet e punës mujore, vjetore dhe raportet financiare;
- 21.5. Për kryerjen e punëve të tij, drejtori i QKMF-së i përgjigjet drejtorit komunal për shëndetësi;
- 21.6. Procedurat për ndërmarrjen e masave ndaj drejtorit të QKMF-së, siç është vërejtja verbale, vërejtja me shkrim apo masa të tjera administrative, mund të iniciohen, duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.

Neni 22

Drejtori ka për detyrë që, gjatë punës dhe vendimeve që i merr Këshilli drejtues, të tërheqë vëmendjen:

- a. Nëse aktet e propozuara janë në kundërshtim me ligjet relevante, përkatësisht, në kundërshtim me aktet e përgjithshme të QKMF-ës,
- b. Nëse akti i propozuar është në kundërshtim me Programin e punës së QKMF-së,
- c. Nëse akti i propozuar nuk i kontribuon qëllimit.

Trupat e QKMF-së

Neni 23

23.1. Për përmbushjen e detyrave të veçanta, Këshilli drejtues, përmes drejtorit të QKMF-së, formon trupa profesionale në QKMF, siç janë:

- a. Këshilli Profesional,
- b. Komisioni Disiplinor i QKMF,
- c. Komisioni i Ankesave i QKMF,
- ç. Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve,
- d. Komiteti për Zhvillim të Vazhdueshëm Profesional,
- dh. Komiteti Etiko– Profesional etj.

23.2. Anëtarët e trupave profesionale, emërohen nga drejtori i QKMF-së;

23.3. Këshilli drejtues, përmes drejtorit të QKMF-së, sipas nevojës, mund të formojë edhe trupa të tjerë profesional në QKMF.

Këshilli Profesional

Neni 24

24.1. Këshilli profesional është trup këshillëdhënës i drejtorit të QKMF-së;

24.2. Këshilli profesional përbëhet nga kryeshefat e departamenteve, kryeinfermieri/ja e QKMF-së, shefat e sektorëve dhe njësive, shefi i barnatores, sipas nenit 11 të këtij statuti;

24.3. Kryetar i Këshillit profesional, sipas detyrës zyrtare, është kryeshefi i Departamentit të Mjekësisë Familjare i QKMF-së;

24.4. Këshilli profesional sjell Rregulloren e punës për punën e këshillit.

Neni 25

25.1. Kryetari i Këshillit profesional i kryen këto punë:

a. përgatit, thërret dhe udhëheq mbledhjet e Këshillit profesional,

b. verifikon rendin e ditës së mbledhjeve, dhe

c. siguron mbajtjen e procesverbalit të mbledhjes;

25.2. Kryetari i Këshillit profesional është i obliguar ta thërras mbledhjen brenda 3 (tri) ditësh, nga dita kur këtë e kërkon drejtori i QKMF-së;

Neni 26

Këshilli profesional i QKMF-së, përveç detyrave të parapara me ligj, i kryen edhe këto detyra:

a. Shqyrton dhe vendos për nevojën dhe arsyet profesionale të implementimit të metodave dhe procedurave të reja diagnostifikuese dhe terapeutike,

b. I propozon Këshillit drejtues dhe drejtorit, marrjen e masave profesionale për përmirësimin e organizimit të punës dhe kushteve për zhvillimin e veprimtarisë,

c. Propozon strukturën e mbikëqyrjes së brendshme, lidhur me punën e punëtorëve shëndetësor, si dhe masat për përmirësimin e punës profesionale,

ç. Shqyrton nevojën për zhvillim të vazhdueshëm profesional dhe i propozon drejtorit dërgimin e punëtorëve shëndetësorë në përsosje profesionale, dhe

d. Shqyrton dhe vendos për çështje të tjera, të cilat drejtori ia parashtron Këshillit profesional.

Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve

Neni 27

27.1. Në QKMF duhet të funksionojë Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore;

27.2. Komiteti për Siguri të Cilësisë, përbëhet nga 3 anëtarë të emëruar nga Këshilli drejtues;

27.3. Komitetin për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore e udhëheq koordinatori/ja në QKMF;

27.4. Koordinatorin/ja është profesionisti shëndetësor i/e trajnuar në standardet e cilësisë, i/e cili rekrutohet sipas legjislacionit në fuqi;

Neni 28

Komiteti për Siguri të Cilësisë së Shërbimeve Shëndetësore, është trup, i cili siguron cilësinë e shërbimeve shëndetësore në QKMF, përmes:

- a) Hulumtimeve dhe auditeve të brendshme klinike dhe organizative,
- b) Organizimit të rishqyrtimeve kolegjiale,
- c) Mbikëqyrjes së punës profesionale mjekësore të ekipeve të Mjekësisë familjare,
- d) Propozimit të masave për përmirësim të gjendjes.

Këshilli Etik

Neni 29

29.1. Këshilli Etik, është trup, i cili siguron kryerjen e veprimtarisë së QKMF-së, mbi bazat e etikës dhe deontologjisë.

29.2. Anëtarët e Këshillit etik i emëron Këshilli drejtues;

29.3. Këshilli etik përbëhet nga 5 anëtarë, të cilët duhet të jenë:

- a) 4 (katër) përfaqësues të QKMF-së (3 nga profesioni mjekësor dhe 1 nga profesioni jomjekësor),
- b) 1(një) person i cili është i profesionit jomjekësor, duhet të jetë nga shoqëria civile dhe të jetë individ i spikatur për punën shkencore ose shoqërore,
- c) 1/3 e anëtarëve të Këshillit etik duhet të jenë të gjinisë femërore.

Neni 30

30.1. Këshilli etik i QKMF-së, gjatë ushtrimit të veprimtarisë në QKMF, kryen këto punë:

- a. Përcjell implementimin e veprimtarive etike dhe deontologjike në lëmin e shëndetësisë,
 - b. Miraton kërkime shkencore në QKMF, sipas dispozitave ligjore që rregullojnë këtë lëmi,
 - c. Shqyrton çështje tjera etike lidhur me veprimtarinë e QKMF-së;
- 30.2.** Këshilli etik bën rregulloren e punës së këshillit.

Neni 31

Detyrat dhe përgjegjësitë e trupave të tjerë përcaktohen me aktet nënligjore, të nxjerra nga Këshilli drejtues, përmes drejtorit të QKMF-së, nëse ato nuk janë të përcaktuara me akte të tjera nga MSH.

VI. Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional

Neni 32

32.1. Në kuadër të QKMF-së, organizohet Zhvillimi i Vazhdueshëm Profesional i të gjithë punëtorëve shëndetësorë, bazuar në dispozitat e Ligjit për Shëndetësi dhe të akteve të tjera nënligjore që rregullojnë këtë lëmi.

32.2. Aktivitetet e Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional (ZHVP), të Edukimit Specialistik Pasdiplomik (ESP) dhe atij të Edukimit Themelor (ETH), për punëtorët shëndetësorë në KPSH, mbahen në Qendrën e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare (QZHMF), në Qendrat Klinike Universitare të Kosovës, në Qendrat për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik, në Qendrat e Trajnimit të Mjekësisë Familjare dhe në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës;

32.3. Për zhvillimin e aktiviteteve, nga neni 32.2. përgjegjës janë koordinatorët dhe trajnuesit në programet e Mjekësisë familjare dhe të Infermierisë familjare, të cilët duhet të kenë përgatitje adekuate akademike dhe profesionale dhe që caktohen nga Qendra e Zhvillimit të Mjekësisë Familjare dhe Qendra për Edukim të Vazhdueshëm Infermierik e Ministrisë së Shëndetësisë, në bashkëpunim me QKMF-në;

32.4. Ministria bazuar në aktet nënligjore për ZHVP, Edukim Specialistik Pasdiplomik, me propozim të Komiteteve Specialistike të lëmive përkatëse, emërton mentorët klinik për specializantët e Mjekësisë familjare;

32.5. Titujt profesional dhe akademik do të njihen me sistematizimin e vendeve të punës në QKMF dhe njëherësh do të gradohen sipas ligjeve dhe rregulloreve që rregullojnë këtë lëmi;

32.6. Financimi i ZHVP-së, i punëtorëve shëndetësor, bëhet nga buxheti i QKMF-së dhe burime të tjera të disponueshme;

32.7. Komiteti për ZHVP përbëhet nga 3 anëtarë të emëruar nga Këshilli drejtues;

32.8. Komitetin për ZHVP e udhëheq koordinatori/ja në QKMF.

VII. Mbikëqyrja e QKMF-së

Neni 33

33.1. QKMF-ja i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore dhe profesionale që sigurohet përmes DSHPS-së dhe autoriteteve të përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë;

33.2. Mbikëqyrja e brendshme e punës profesionale kryhet në mënyrën e paraparë me Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme, të cilën e propozon Këshilli drejtues i QKMF-së;

33.3. Mbikëqyrja dhe monitorimi i QKMF-së përfshin:

a. Mbikëqyrjen dhe inspektimin e objekteve të KPSH-së për infrastrukturën dhe menaxhimin e objekteve,

b. Mbikëqyrjen dhe inspektimin e ofrimit të cilësisë së shërbimeve shëndetësore, sipas normave dhe standardeve të përcaktuara nga ministria,

c. Mbikëqyrjen dhe monitorimin e raporteve dhe procedurave financiare, për menaxhimin e fondit të alokuar, të paraparë nga Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Financave dhe Rregullat e prokurimit publik;

33.4. Nëse hasen vështirësi në realizimin e detyrave të QKMF-së, Ligjit për Shëndetësi, si dhe detyrave dhe obligimeve që përcaktohen me këtë statut, Drejtoria për Shëndetësi do të ndërmarrë masat për eliminimin e tyre, e nëse edhe kjo drejtori nuk mund të përmirësojë situatën në afatet e përcaktuara, atëherë kjo ministri do të ndërmarrë masat e duhura administrative për eliminimin e parregullsive, në bazë të Ligjit për Shëndetësi.

VIII. Aktet e përgjithshme

Neni 34

Aktet e përgjithshme të QKMF-së janë: Statuti, Udhëzimet administrative, Rregulloret e punës dhe vendimet, përmes të cilave rregullohen çështjet nga veprimtaria e institucionit.

Neni 35

Me propozim të drejtorit, Këshilli drejtues i QKMF-së, nxjerr këto akte të përgjithshme:

- a. *Rregulloren për organizimin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës,*
- b. *Rregulloren për punë,*
- c. *Rregulloren për gradim, pagesa dhe të drejta të tjera materiale të punëtorëve, nëse me akte të tjera nuk është rregulluar ndryshe,*
- ç. *Rregulloren për mbrojtjen në punë,*
- d. *Rregulloren për mbrojtjen kundër zjarrit,*
- dh. *Rregulloren për kontabilitetin e brendshëm,*
- e. *Rregulloren për rendin shtëpiak,*
- ë. *Rregulloren për mbikëqyrjen e brendshme,*
- f. *Rregulloren për parandalimin e infeksioneve dhe*
- g. *Rregullore të tjera për mbarëvajtjen e punës në QKMF.*

IX. Pronësia, Buxheti dhe Financat

Pronësia

Neni 36

Pasurinë e QKMF-së e përbëjnë asetet, të drejtat dhe të mirat materiale, të cilat kanë qenë të evidentuara si pronë shoqërore, me të cilat QKMF-ja ka pasur të drejtë të disponojë në ditën e hyrjes në fuqi të Ligjit për Shëndetësinë e Kosovës.

Buxheti Neni 37

- 37.1.** Çështjet buxhetore dhe financiare të QKMF-së administrohen në mënyrë transparente, në pajtim me rregulloret për përdorimin e fondeve nga Buxheti i Kosovës, si dhe me të gjitha procedurat, në përputhje me udhëzuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave;
- 37.2.** Buxheti dhe llogaritë e QKMF-së duhet të përfshijnë tërë shpenzimet operative të njëjësive punuese;
- 37.3.** Prokurimi i QKMF-së bëhet në pajtim me rregullat e Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës;
- 37.4.** Drejtori mund të kërkojë revizion të jashtëm dhe të monitorojë shfrytëzimin e drejtë të mjeteve.

Financimi Neni 38

- 38.1.** QKMF-ja shfrytëzon burimet financiare në harmoni me Ligjin për Shëndetësi të Kosovës, nga Buxheti i Kosovës dhe nga burimet e tjera, të parapara me ligjet përkatëse;
- 38.2.** Bashkëpagesa për shërbimet e ofruara në QKMF, si burim i financimit të aktiviteteve të QKMF-së, do të bëhet në bazë të çmimoreve të aprovuar nga Ministria e Shëndetësisë;
- 38.3.** QKMF propozon çmime për shërbimet, të cilat nuk janë të parapara me çmimin nga ministria dhe të cilat nuk ndeshen me aktet ligjore në fuqi.

X. Transparenca në punë Neni 39

Struktura, kushtet, mënyra e ofrimit të shërbimeve shëndetësore, si dhe kryerja e veprimtarisë së QKMF-së, janë publike dhe transparente ndaj personave juridik dhe fizik, përveç kur bëhet fjalë për sekret afarist dhe profesional.

Neni 40

Informatat dhe të dhënat për veprimtarinë, si dhe shikimi në dokumentacionin për veprimtarinë shëndetësore, personave të autorizuar apo mjeteve të informimit mund t'ua japë vetëm drejtori, ose punëtori i QKMF-së, të cilin ai e autorizon.

XI. Konfidenca profesionale

Sekreti Afarist dhe Profesional Neni 41

Zbulimi i sekretit afarist konsiderohet dhënia e dokumentacionit dhe e të dhënave të tjera në shikim personave të paautorizuar, veprim i cili do t'i shkaktonte dëm reputacionit dhe interesit afarist të QKMF-së.

Neni 42

Sekrete afariste konsiderohen:

- a) Dokumentet, të cilat drejtori i QKMF-së i konsideron si sekret afarist,
- b) Të dhënat, të cilat organi kompetent i konsideron sekrete dhe ia ofron institucionit si të tilla,
- c) Masat dhe mënyra e veprimit, në raste të krijimit të situatave të jashtëzakonshme,
- ç) Dokumentacioni që përmban planin e mbrojtjes fiziko-teknike të punëtorëve dhe të pasurisë së institucionit, si dhe
- d) Të dhënat e tjera, publikimi i të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e institucionit dhe themeluesit të tij.

Neni 43

43.1. Mosruajtja e sekretit afarist, konsiderohet shkelje e rëndë e detyrave të punës;

43.2. Për ruajtjen e sekretit afarist, drejtpërsëdrejti kujdeset drejtori i QKMF-së.

XII. Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare

Neni 44

Aktet e përgjithshme, nga neni 32 dhe 33 të këtij statuti, duhet të harmonizohen në afat prej 90 ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi.

Neni 45

Me hyrjen në fuqi të këtij statuti, shfuqizohen aktet e tjera që kanë rregulluar punën e QKMF-së, e që janë në kundërshtim me këtë statut.


Neni 46

Ky Statut hyn në fuqi 8 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

Kryesuesi i Kuvendit
Shpëtim Zhegrova




Mbishkrimi i QKMF




QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE
GLAVNI CENTAR PORODIČNE MEDICINE • MAIN FAMILY HEALTH CENTRE
PRISHTINË • PRISHTINA • PRISTINA

Logo e QKMF



Vulat e QKMF...



Dr. Valdet Hashani, MD, MSc, PhD.